



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 80, datë 24.12.2020

**PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2021 DHE PROGRAMIT BUXHETOR
AFATMESEM PERFUNDIMTAR 2021 – 2023, NUMRIN E PUNONJËSVE TË
BASHKISË VAU DEJËS.**

Këshilli Bashkiak Vau Dejës në mbledhjen e tij të datës 24.12.2020, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në nenin 9 pika 1.3 shkronja "c", nenet 34-37, 40, 41, 54 shkronja "dh" të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar ; kreu III, nenet 10-20, kreu IV, nenet 22-30, kreu VI neni 2, kreu VII, nenet 39-41 të ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore"; ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" të ndryshuar;

Ligji 137/2020 "Për buxhetin e vitit 2021", Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23 datë 30.07.2018 "Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesem të NJQV"; Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9 datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", Udhëzimi nr. 10, datë 28.02.2020 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesem vendor 2021-2023" dhe shtojcat plotësuese; Udhëzimi nr. 27, datë 10.07.2020 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesem vendor 2021-2023" dhe shtojcat plotësuese ; Shkresa e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me nr. 19697 datë 20.10.2020 "Dërgohet për njoftim transfertat e pakushtëzuar dhe specifike, për vitin 2021", si dhe shkresa nr 23727 datë 21.12.2020 "Dërgohet transfertat e pakushtëzuar të përgjithshme dhe sektoriale, për vitin 2021", dhe relacionit të administratës së Bashkisë Vau Dejës. Në mbledhjen e datës 24.12.2020 me propozim të Kryetarit të Bashkisë:

**KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I:**

1. Miratimin e buxhetit të vitit 2021 dhe programin buxhetor afatmesem përfundimtar për vitet 2021 - 2023, të Bashkisë Vau Dejës, si më poshtë:
 - a) Miratimin e fondeve buxhetore, të parashikuara sipas programeve buxhetore për çdo njësi shpenzuese, për vitet 2021-2023, të ndara në korrente dhe kapitale; sipas tabelës 1, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
 - b) Miratimin e tavanëve për çdo program, për vitin 2021- 2023 të programit buxhetor afatmesëm sipas tabelës F2 të FPT (Instrumentit të Planifikimit Financiar), pjesë përbërëse e këtij vendimi.

- c) Miratimin e të ardhurave sipas përputhshmërisë me rregullat fiskale në fuqi dhe shpenzimet e buxhetit, sipas zërave kryesorë, për dy vitet e mëparshme buxhetore dhe tre vitet e ardhshme, sipas tabelës F1 dhe F2 të FPT, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
 - d) Miratimin e numrit të punonjësve të Bashkisë Vau Dejës dhe institucioneve në varësi për vitin 2021, sipas tabelës nr. 2, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
 - e) Miratimin e detajimit të shpenzimeve sipas klasifikimeve buxhetore për vitet 2021-2023 sipas tabelës F10 të FPT, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
 - f) Miratimin e listës së projekteve të investimeve publike, për çdo program, sipas tabelës F15 dhe E3 të FPT, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Tabelat shoqeruese:
 - a) Projektin e parë të planit të arkës të të ardhurave të veta të vitit 2021. sipas tabelës pjesë përbërëse e këtij vendimi.
 3. Fondet e papërdorura në fund të vitit 2020, me burim financimi nga transferata e pakushtëzuar, transferata specifike dhe të ardhurat e veta, do të jene pjesë e buxhetit të vitit 2021.
 4. Është kompetencë e Kryetarit të Bashkisë:
 - a) Rishpërndarja e projekteve të investimeve, brenda të njëjtit program;
 - b) Rishpërndarja ndërmjet zërave të shpenzimeve korrente, brenda të njëjtit program;
 - c) Rishpërndarja brenda të njëjtit program dhe zërit të shpenzimeve korrente, ndërmjet njësisive të ndryshme shpenzuese.
 5. Efektet e këtij vendimi janë nga data 1 janar deri në 31 dhjetor.
 6. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë për marrjen e këtij vendimi.
 7. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55 pika 6 të ligjit nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”).

KRYETAR


 Sekretari i Këshillit Bashkiak
 Ardian Çelepija


 Mark Bisha

Miratuar me 25 vota

Vota Pro 25

Vota Kundër —

Vota Abstenim —

Zbardhur me datë 31.12.2020.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJËS

RELACION

Për raportin e vlerësimit dhe parashikimit afatmesëm të të ardhurave të veta dhe mbi miratimin e tavanëve përfundimtare të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2021-2023 për Bashkinë Vau Dejës

A. Raporti i vlerësimeve dhe parashikimeve afatmesme të të ardhurave të veta

Të ardhurat e veta përfshijnë të gjitha burimet e të ardhurave, me përjashtim të transfertës nga burimet qendrore. Këto burime të ardhurash bashkia i përdor për financimin e funksioneve të përcaktuara nga Ligji 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

Planifikimi i të ardhurave nga taksat/tarifat është mbështetur në paketën fiskale të Bashkisë Vau dejes, e cila përcakton llojet e taksave, bazën e taksueshme, kategorizimet dhe nënkategorizimet, këstet e pagimit, kohën e kryerjes së tyre, efektet e lehtësive, strukturat përgjegjëse për vjeljen e detyrimeve dhe agjentët tatimorë.

Paketa fiskale përcakton rregullat për mënyrën e ushtrimit të të drejtave dhe të detyrave nga organet e qeverisjes vendore, për vendosjen e taksave vendore, mbledhjen dhe administrimin e tyre.

Në mënyrë të hollësishme, përveç strukturimit, detajon çdo lloj takse të administruar nga organet vendore të administrimit, përcakton qartë edhe administrimin e saj duke filluar me mënyrën e llogaritjes, personat përgjegjës të pagimit të taksës dhe ato të mbledhjes së saj.

Paketa fiskale e bashkisë Vau dejes për këtë kategori e hartuar dhe e ndryshuar edhe me përfshirjen e përfaqësuesve të komunitetit të biznesit e më konkretisht biznesit të madh dhe të vogël, banorëve të njësive administrative, përfaqësues të komunitetit sipas interesit, këshilltarë etj., pasqyron disa politika të rëndësishme për uljen e disa niveleve ligjore/kufi, etj. Sipas kompetencave ligjore, si më poshtë:

Politikat incentivuese në taksa:

- Ulje e taksës së ndërtesës për qëllime banimi deri në 30% nga referenca ligjore
- Taksë 0 (zero) ndërtese për qëllime banimi për invalidët.
- Ndarja në keste e likuidimit të detyrimit.
- Nivelin minimal ligjor për taksën e ndikimit në infrastrukture dhe uljet nën nivelet e koston të shërbimit të llogaritur:
- Tarifa zero për shërbimin e pastrimit, ndricimit dhe gjelbërimit për familjaret e zonave rurale.
- Tarifa të reduktuara deri në 50% për invalidet dhe kryefamiljet femra që trajtohen me ndihme ekonomike.


Procesi i planifikimit të të ardhurave të veta u realizua në bashkëpunim me administratën e bashkisë, Njësitë Administrative, me Institucionet e Agjentët tatimorë, etj. Vazhdimi i këtij procesi bashkëpunues do të mundësojë sigurimin e të ardhurave, me efekt përmirësimit e mëtejshëm të shërbimeve që ofron bashkia ndaj qytetarëve të saj, duke realizuar objektivat madhorë në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm të të gjithë territorin e bashkisë Vau dejes.

Te ardhurat nga burimet e veta vendore perfshijne te ardhurat nga taksat, te ardhurat nga tarifate dhe nga burime te tjera.

Të ardhurat e veta të Bashkisë për vitin 2021-2023 (000/lekë)

Tabela 1

000/leke	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023
Te ardhurat e veta	186,854	192,460	198,233
-Te ardhura nga taksat vendore	72,893	75,080	77,332
-Te ardhura nga Taksat e ndara	23,610	24,318	25,048
-Te ardhura nga tarifate vendore	68,021	70,062	72,163
-Te ardhura te tjera	22,330	23,000	23,690



Grafiku 1 Te ardhurat nga burimet e veta

Zerat e taksave dhe tarifave qe ndikojne ne pjesen me te madhe te planit te te ardhurave nga burimet e veta per vitin 2021, jane kryesisht, taksa e pasurise qe ze 25% , tarifa per pastrimin 13%, taksa mbi token bujqesore 8%, taksa e mjeteve te perdorura 6%, taksa e ndikimit ne infrastrukture nga ndertimet e reja 13%, dhenie me qera aseteve 16%.

Tabela e meposhtme pasqyron planin e te ardhurave te veta , te kategorizuar sipas klasifikimit

ekonomik ligjor.

Tabela 2. Te ardhurat e veta te Bashkise Vau-dejes

LLOJET E TË ARDHURAVE	Realizim 2018	Realizimi 2019	I pritshmi 2020	Plani 2021	Plani 2022	Plani 2023
TË ARDHURAT NGA BURIMET E VETA GJITHSEJ	126,451	116,290	180,000	186,854	192,460	198,233
TË ARDHURA NGA TAKSAT VENDORE	40,402	61,157	71,145	72,893	75,080	77,332
Të ardhura nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël	546	643	500			
Të ardhura nga taksa mbi Biznesin e vogel (e prapambetur)		-	20	30	31	32
Te ardhura nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme	30,119	32,041	45,000	50,763	52,286	53,854
Të ardhura nga taksa e fjetjes në hotel	12	-	25	100	103	106
Të ardhura nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	8,295	27,339	23,600	20,000	20,600	21,218
Të ardhura nga taksa e tabelës	1,430	1,134	2,000	2,000	2,060	2,122
TE ARDHURA NGA TAKSAT E NDARA	12,949	13,646	12,610	23,610	24,318	25,048
Te ardhura nga tatimi mbi te ardhurat personale				8,000	8,240	8,487
Të ardhura nga taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme	68	221	500	500	515	530
Të ardhura nga taksa vjetore e mjeteve të përdorura	12,758	13,311	12,000	15,000	15,450	15,914
Të ardhura nga taksa e rentës minerare		9	10	10	10	11
Të ardhura nga taksa e akteve të pullë	123	105	100	100	103	106
TE ARDHURA NGA TARIFAT VENDORE	43,833	35,531	57,345	68,021	70,062	72,163
Te ardhura nga tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave	31,049	25,418	24,000	32,686	33,667	34,677
Të ardhura nga tarifa për ndriçimin publik	3,157	2,700	4,500	9,319	9,599	9,887
Të ardhura nga tarifa për gjelbrimin	2,942	2,358	3,100	4,547	4,683	4,824
Të ardhura nga tarifa të shërbimit administrativ të bashkisë	6,685	5,055	25,745	21,469	22,113	22,776
TË ARDHURA TË TJERA	20,980	5,696	38,400	22,330	23,000	23,690
TE ARDHURA NGA DONACIONET	8,287	260	500	-	-	-


Tabela e meposhteme pasqyron ne menyre analitike te ardhurat sipas njesive administrative:

Tabela 3

SIPAS NJESIVE

VITET	TOTALI	NJESITE					
		NJA VAUDEJES	NJA BUSHAT	NJA HAJMEL	NJA VIG-MNELE	NJA SHLLAK	NJA TEMAL
VITI 2021	186,853,514	58,535,221	99,386,592	16,882,508	3,257,305	4,495,252	4,296,636

VITI 2022	192,459,119	60,291,278	102,368,190	17,388,983	3,355,024	4,630,110	4,425,535
VITI 2023	198,232,893	62,100,016	105,439,235	17,910,653	3,455,675	4,769,013	4,558,301



Grafiku 2. Planifikimi ardhurave sipas njesive

Pesha kryesore ne realizimin e te ardhurave I ngarkohet Njesise Administrative Bushat, qe ze rreth 49% e planit total te te ardhurave, si dhe Njesise Administrative Vau-dejes qe ze afro 38% e planit total ardhurave, pjesa tjeter Njesite e vogla.

B. Kapaciteti fiskal I taksapaguesve.


Paguesit e nivelit te taksave dhe tarifave vendore jane: bizneset, institucionet dhe familjet e te gjitha njesive administrative. Per percaktimin e numrit te tyre jane konsideruar te dhenat per taksapaguesit, si dhe perjashtimet apo lehtesimet fiskale, sipas paketes fiskale te miratuar nga keshilli bashkiak.

Ne total kapaciteti I taksapaguesve eshte parashikuar rreth 14.400 familje, biznes dhe institucione(. Peshen numerike me te madhe e zene familjet qe perbejne rreth 94% ne nr.)

Me poshte jepet tabela permbledhese e kapacitetit te taksapaguesve sipas kategorive:

Tabela 4


Nr.	Bashkia Vau-Dejes	Familjet	Biznesi vogel	Biznesi madh	Institucione
1	Nj.A Vau-dejes	4151	168	41	1
2	Nj.A Bushat	6333	280	79	0
3	Nj.A Hajmel	2035	29	0	0
4	Nj.A.Vig-Mnele	688	2	1	0
5	Nj.A.Shllak	638	1	1	0
6	Nj.A Temal	555	7	1	0
	TOTAL	14.400	487	123	1



Grafiku 3 taksapagues

B.1 Taksapaguesit familjar.

Ne total numri I familjeve qe parashikohet te perfshihet ne skemne e detyrimeve fiskale te Bashkise Vau-dejes eshte 14.400. Numri I familjeve ne Njesine Administrative Bushat ze peshen kryesore me afro 6 .000 ose rreth 42 % te numrit te pergjithshem te famljeve te Bashkise Vau-dejes, dhe 58% Njesite e tjera.




Grafiku 4 Numri I familjeve te taksapaguesve

Parashikimi I ardhurave nga familjet eshte bere duke ju referuar kapaciteteve reale te familjeve sipas rregjistrir gjendjes civile.

Ne planin e te ardhurave jane parashikuar lehtesi fiskale per familjet me probleme sociale dhe familjet qe jane perfitues te ndihmes ekonomike, per invalidet, pensionistet etj.

B.2 Taksapagues biznese dhe institucione.

Bazuar ne rregjistrat aktual, numri I bizneseve qe parashikohet te perfshihen ne skemen e detyrimeve fiskale te Bashkise Vau-dejes eshte afro 600 biznese,. Biznesi vogel ze rreth 73% te numrit total te bizneseve.




Grafiku 5 numri bizneseve takasapgues

B.3 Kapaciteti I bizneseve sipas kategorise jepen ne tabelen e mepsoshtme:

Tabl
et 5

Nr.	KATEGORIA	N.J.A VAUDEJ ES	N.J.A BUSHA T	N.J.A HAJME L	N.J.A VIG- MNEL E	N.J.A SHLLA K	N.J.A TEMA L	TOTA L
1	SHITJE ME SHUMICE	8	20	1	0	1	2	32
2	SHITJE ME PAKICE	111	129	11	1	0	3	255
3	PRODHUESE	21	30	5	0	0	0	56
4	SHERBIME	62	180	12	2	1	3	260
	TOTAL	202	359	29	3	2	8	603



Grafiku 6. Numri bizneseve sipas kategorise

C. Detaji I te ardhurave sipas zerave, peshave ne te ardhurat e Bashkise.

Të ardhurat nga burimet e veta vendore përfshijnë të ardhurat nga taksat vendore, nga tarifatat për shërbimet publike dhe të ardhurat e tjera vendore. Sipas ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 35/2, bashkitë e ushtrojnë të drejtën e vendosjes së nivelit të taksës, mënyrën e llogaritjes së saj, si dhe mbledhjen e administrimit të tyre brenda kufijve të sipas kriterëve të përcaktuara me ligj. Llogaritja e të ardhurave mbështetet në:


1. Ligjin nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar;
2. Ligjin nr.9920 datë 26.05.2008 “Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë“ i ndryshuar ;
- 3.Vendimet e Këshillit të Bashkisë Vau Dejes ”Për miratimin e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Vau Dejes “, te ndryshuar.

C.1 Te ardhurat nga taksat vendore

Ligji Nr. 9632, date 30.10.2006 “per sistemin e taksave vendore”, me ndryshimet perkatese, perben ligjin baze I cili percakton rregullat per ushrimin e te drejtave dhe detyrave te njesive te qeverisjes vendore ne drejtim te taksave vendore, mbledhjes dhe administrimit te tyre.

Per vitet 2021-2023 parashikohet qe te ardhurat nga taksat te perbejne rreth 37% te te ardhurave nga burimet e veta te Bashkise.

Pjese e rendesishme ne kete kategori taksash jane te ardhurat nga taksa e pasurise se paluajtshme, e cila ze rreth 67% te totalit te te ardhurave nga taksat e veta, dhe me pas vijne taksa e ndikimit ne infrastructure e cila ze rreth 13% dhe taksa e tabelës me rreth 3% , taksa mjeteve perdorura 14%.



Grafiku 7. Pjesa sipas zerave te ardhurave nga taksat vendore

Te Ardhura nga tatimi I thjeshtuar mbi fitimin per biznesin e vogel.

Sipas ligjit Nr. 142/2015, date 17.12.2015 “per disa ndryshime dhe shtesa me ligjin 9632, date 30.10.2006 “Per sistemin e taksave vendore”, neni 11 ka qene

- Shkalla tatimore per subjektet me xhiro nga 0 deri ne 5 milion leke eshte 0 leke,
- Ndersa shkalla tatimore per subjektet me xhiro nga 5 milion deri ne 8 milion eshte 5% e fitimit.

Tatimi I thjeshtuar per biznesin e vogel administratohet nga Drejtoria Rajonale e tatimeve Shkoder, e cila ne rolin e agentit tatimor mban nje komsion prej 1% te vleres se grumbulluar, ndersa 99% kalon ne favor te Bashksie Vau-dejes..

Por me ligjin Nr. 122/2020 “Per disa ndryshime ne Ligjin 9632, date 30.10.2006”Per sistemin e taksave vendore, shkalla tatimore ka ndryshaur dhe eshte bere :

- Per subjektet me xhiro nga 0-8 milion tatami eshte 0 (zero)

Te Ardhura nga Taksa mbi pasurine e paluajtshme

Këto të ardhura përfshijnë te ardhurat nga :

- Taksa mbi ndërtesat (mbi ndërtesat e banimit dhe mbi ndërtesat e tjera)
- Taksa mbi tokën bujqësore
- Taksa mbi truallin

Parashikimi për vitet 2021-2023 bazohet te zgjerimi i bazës së taksapaguesve nëpërmjet:

- saktësisimit dhe vlerësisimit të drejtë të sipërfaqeve nëpërmjet grupeve të punës të ngritura për këtë qëllim,
- Mbështetja nga agjentë tatimorë.

- Ndarjes në këste të pagesave,
- shtrirje e mëtejshme e bazës taksapaguese, falë politikave fiskale lehtësuese dhe incentivave të ndërmarra, rivlerësimit të gjendjes faktike, përmirësimit të shërbimit dhe marrëdhënies me taksapaguesin, bashkëpunimit të pritshëm me institucione si ZRRPP, ALUIZNI, si dhe krijimit të kadastrës fiskale, etj.

a) Të ardhura nga taksa mbi ndërtesat

Me ndryshimet në ligjin 9632 “Për sistemin e taksave vendore”, me Ligj Nr. 106/2017, date 30.11.2017. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr.222, date 19.12.2017, ndryshon shkalla e taksës mbi ndërtesat, e cila aplikohet si përqindje e bazës së taksës, si më poshtë:

- 0,05% për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për banim;
- 0,2% për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për veprimtari ekonomike;

Taksa vendore mbi pasurinë e paluajtshme-ndërtesë llogaritet si detyrim vjetor i taksapaguesit. Pagesa e taksës bëhet çdo muaj apo për periudha më të gjata, në varësi të kategorisë së taksapaguesit, sipas përcaktimeve në vendimin e Këshillit të Ministrave.

Baza e taksës mbi ndërtesat është vlera e ndërtesës, që llogaritet në përputhje me metodologjinë dhe procedurat e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

b) Të ardhura nga Taksa mbi tokën bujqësore

Kjo taksë administrohet nga Bashkia Vau dejes . Baza e taksës është sipërfaqja e tokës bujqësore, në hektar, në pronësi ose në përdorim të taksapaguesit.

Niveli tregues i taksës mbi tokën bujqësore sipas kategorizimeve, jepet në tabelën më poshtë:

Tabela 6

Kategoritë mesatare e tokës bujqësore	Njësia	Niveli sipas ligjit (lek/ha/vit)
I	lek/ha/vit	4,200
II	lek/ha/vit	3,500
III	lek/ha/vit	2,800
IV	lek/ha/vit	2,300
V	lek/ha/vit	1,900
VI	lek/ha/vit	1,600
VII – X	lek/ha/vit	1,400


Planifikimi i të ardhurave bazohet mbi kapacitetin aktual fiskal të njësive administrative, mbi parashikimin për zgjerimin e bazës së taksapaguesve nga grupet e punës nëpërmjet saktësimit të sipërfaqeve reale dhe kategorizimit të saktë dhe aktual të tokës bujqësore, si dhe duke iu referuar tendencës në rritje të kapacitetit të realizimit të të ardhurave ndër vite. Referuar kategorive të tokës, pjesa më e madhe e të ardhurave nga taksa mbi tokën bujqësore vjen nga tokat bujqësore të kategorisë së IV dhe të kategorisë së V. Të ardhurat nga taksa e tokës bujqësore parashikohen me një rritje prej 10% në vit.

c) Të ardhura nga Taksa mbi truallin

Baza e taksës mbi truallin është sipërfaqja e truallit, në metër katror, në pronësi apo përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e truallit në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë. Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i truallit bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së truallit në përdorim, pranë bashkisë ku ndodhet trualli. Për çdo kategori minimale të truallit, këshilli bashkiak mund të miratojë nënkategorizime.

Për bizneset kjo taksë administrohet nga Bashkia Vau dejes, dhe faturet me keste 3-mujore _____

Planifikimi i të ardhurave është bërë duke u bazuar në sipërfaqet aktuale, dhe mbi parashikimin përzgjerimin e bazës së taksapaguesve nga grupet e punës nëpërmjet saktësimin të sipërfaqeve. Të ardhurat nga taksa e truallit parashikohen me një rritje prej 10% në vit. Pjesa më e madhe e sipërfaqes së taksueshme, rreth 60% e totalit, është në Njësia Administrative Bushat . Nga të ardhurat në total të parashikuara nga taksa e truallit, 60% mbulohet nga Njësia Administrative Bushat dhe pjesa tjetër nga Njësia e tjera. Referuar kategorive të truallit, pjesa më e madhe e të ardhurave të parashikuara nga kjo takse vjen nga trojet për qëllime biznesi (rreth 80%).



Grafiku 9 të ardhura nga taksa truallit sipas kategorizimit

Të ardhura nga Taksa e fjetjes në hotel

Kjo taksë administrohet nga Bashkia Vau dejes.

Me "Hotel" kuptohet çdo subjekt tregtar që jep strehim kundrejt pagesës dhe përfshin emërtimet hotel, motel, stabiliment turistik, pension, shtëpi pritjeje, turizëm familjar dhe çdo objekt tjetër që përdoret për këtë qëllim.

Baza e taksës së fjetjes në hotel është numri i netëve të qëndruara në hotel për person, dhe përcaktohet me ligj.

Detyrimi për taksën i takon klientit që strehohet në hotel, detyrim i cili mbahet nga hoteli për llogari të bashkisë, në territorin e së cilës ndodhet hoteli. Në faturën e hotelit shënohet çmimi i fjetjes, dhe mbi të vlera e taksës.

Parashikimi i të ardhurave nga taksa e fjetjes në hotel për vitet 2021-2023, është si më poshtë:

Tabela 7

	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023
Taksa e fjetjes në hotel	100	103	106

Të ardhura nga Taksa e ndikimit në infrastrukturë

Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja administrohet nga Bashkia Vau dejes.

Bazuar në ligjin 9632, taksa e ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja përcaktohet në kufijtë 4-8% e çmimit të shitjes për ndërtime për qëllime banimi apo njësi shërbimi nga shoqëritë e ndërtimit, të cilat nuk destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, industrisë apo përdorim publik. Bashkia Vau dejes aplikon taksën minimale të lejuar nga ligji, 4% e çmimit të shitjes. Çmimi i shitjes për metër katror bazohet në vlerën referuese të vlerës së tregut sipas përcaktimeve të udhëzimit të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave, nga Enti Kombëtar i Banesave", që miratohet çdo vit.

Taksa e ndikimit në infrastrukturë për ndërtime të ndryshme nga ato të përmendura më lart është 3% të vlerës së investimit që kërkohet të kryhet.

Bazuar në Ligjin Nr. 9482 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", taksa për ndërtesat në proces legalizimi llogaritet 0,5% e vlerës së investimit.

Plani i të ardhurave nga taksa e ndikimit në infrastrukturë bazohet mbi parashikimin e lejeve për

ndërtime të reja dhe shlyerjen e detyrimeve për objektet në proces legalizimi .

Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet në proces legalizimi administrohet nga Bashkia Vau dejes. Vjelja e kësaj takse paraqet vështirësi për Bashkinë Vau dejes, për arsye se subjektet dhe familjarët pasi kryejnë procedurat e legalizimit pranë ALUIZNI-it, arrijnë të kryejnë regjistrimin e pronës pa shlyer detyrimin përkatës. Realizimi i ardhurave nga kjo taksë lidhet dhe bazohet në zbatimin e masave shtrënguese, bllokimin e shërbimit të debitorëve nga bashkia Vau dejes, si dhe në mbështetjen nga ZRRPP-ja.

Referuar nivelit të takses pritshmërisë së lejeve për shqyrtim e miratim (pershire edhe ato te depozituara prej kohesh prane Bashkise Vau Dejes), per vitet 2021-2023, parashikimi nga kjo takse, paraqitet:

Tabela 8

	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023
Taksa e ndikimit ne infrastrukture nga ndertimet e reja	20 000	20 600	21 218

Të ardhura nga Taksa e Tabelës

Bazuar ne Ligjin Nr. 9632, dt.30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", taksa e tabelës aplikohet për tre lloje tabelash, të përcaktuara sipas qëllimit të përdorimit dhe mënyrës së vendosjes së tyre:

Tabela për qëllime identifikimi brenda territorit te ku zhvillohet biznesi, të cilat nëse janë të trupëzuara në sipërfaqen e ndërtesës. Tabelat me sipërfaqe më të vogël se 2 m² nuk taksohen, ndersa per sip.me te medha sipas llojit te tabeles.

Tabela për qëllime identifikimi jashte territorit, ku përfshihen tabelat identifikuese.

Tabela per qellime reklamimi, qe mund te jene te thjeshta ose elektronike

Tabela për qëllime ekspozimi, ku përfshihen tabelat me karakter të përkohshëm, për ekspozimeve të ndryshme të hapura, panairë, spektakle., stenda reklamuese, banderola, etj. Konkretisht, kundrejt te pritshmit te të ardhurave për vitin 2019, numrit te subjekteve të evidentuara dhe nivelit te takses se miratuar sipas ligjit, parashikimi i te ardhurave per 2021-2023, paraqitet në tabelën si më poshtë:

Tabela 9

	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023
Taksa e tabelës	2 000	2 060	2 122

C.2 Të ardhurat nga Taksat e Ndara

Të ardhurat nga taksat e ndara bazohen në Ligjin nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Neni 25, Njësitë e vetëqeverisjes vendore marrin një përqindje nga taksat ose tatimet kombëtare që realizohen në juridiksionin e tyre. Taksat kombëtare që ndahen me njësitë e vetëqeverisjes vendore janë:

- 97 % e të ardhurave nga taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasurinë e paluajtshme për individë, personat fizikë dhe juridikë;
- 25 % e të ardhurave nga taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura;
- 5 % e të ardhurave nga renta minerare, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin për taksat kombëtare;
- ç) 2 % e të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat personale.

Sipas ligjit, të ardhurat e arkëtuara nga taksat e ndara transferohen te njësitë e vetëqeverisjes vendore deri në fund të muajit pasardhës.

Për vitet 2021-2023 të ardhurat e parashikuara për bashkinë Vau dejes nga taksat e ndara përbëjnë rreth 7 % të të ardhurave nga burimet e veta vendore.

Të ardhura nga Taksa e regjistrimit të mjeteve të përdorura

Bazuar ne ligjin 9975 dt. 28.07.2008 “Për Taksat Kombëtare” të ndryshuar përcaktohet administrimi I taksës kombëtare të regjistrimit të mjeteve të përdorura, ku pas arkëtimit nga institucione shtetërore ne rolin e agjentëve tatimorë, një pjesë e këtyre te ardhurave transferohen në buxhetin e njësisive të qeverisjes vendore sipas përkatësisë nga burojnë.

Referuar pikës 3, të Nenit 4 të Ligjit 9975, Drejtoria e Përgjithshme e Transportit Rrugor në rolin e agjentit tatimor, arkëton detyrimin nga pronari i mjetit për vlerën e taksës për automjetin, para kryerjes së kontrollit teknik vjetor të detyrueshëm të mjetit. Bazuar në numrin e mjeteve të regjistruara, 25 % e të ardhurave nga kjo taksë kalon për llogari të Bashkinë Vau dejes.

Planifikimi bëhet nga agjenti tatimor referuar numrit të automjeteve si dhe bazuar në eksperiencën e viteve të kaluara rereferuar të dhënave për nivelet e arkëtimeve.

Tabela 10

	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023
Taksa mjeteve përdorura	15 000	15 450	15 914

Të ardhura nga taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme

Kjo taksë administrohet nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Taksa me nivelet sipas Ligjit Nr.9632 paguhet para kryerjes së regjistrimit, nga personi që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, dhe vendoset për ndërtesat dhe të gjitha pasuritë nga zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, të cilat, në rolin e agjentit tatimor përfitojnë 3% të shumës së arkëtuar, ndërsa diferencën prej 97% e derdhen për llogari të buxhetit përkatës të bashkisë Vau dejes, jo më vonë se data 30 e muajit pasardhës.

Planifikimi bëhet nga agjenti tatimor si dhe bazuar në eksperiencën e viteve të kaluara rereferuar numrit të procedurave të tjetërsimit të pronës të kryera nga vetë ato.

Bazuar ne keto nivele te taksës jane kryer dhe kalkukimet per parashikimin e saj per vitet 2021-2023 , si me poshte:

Tabela 11

	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023
Taksa mbi kalimin të drejtës së pronësisë për pasuritë e	500	515	530

Të ardhura nga Taksa e Rentës minerare

Bazuar në nenin 4 i ligjit nr.9975, datë 28.7.2008 “Për Taksat Kombëtare” i ndryshuar, baza e taksës së rentës minerare llogaritet mbi burimet natyrore që nxjerr nga nëntoka çdo person fizik apo juridik, në çastin kur ai shet produktin. Personi fizik apo juridik, që është i licencuar dhe/ose vepron në industrinë minerare, sipas një marrëdhënieje kontraktuale me ministrin përgjegjës për ekonominë, duhet të paguajë rentë minerare për burimet natyrore që nxjerr nga nëntoka. Renta minerare llogaritet si detyrim mujor i subjektit taksapagues, në çastin kur ai shet produkte minerare.

Degët e doganave në rrethe ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente, në rastin e eksportit të produkteve minerare, ndërsa degët e tatimeve ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente, në rastin e shitjes së produkteve minerare brenda vendit, (5%) e të ardhurave të realizuara nga kjo taksë i

kalon përkatësisht Bashkisë Vau Dejes në llogarinë e degës së thesarit. Planifikimi i të ardhurave i referohet realizimit të të ardhurave ndër vite. Të ardhurat nga taksa e rentës minerare parashikohen me një rritje prej 10% në vit.

Tabela 12

	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023
Renta minerare	10	10	11

Të ardhura nga tatimi mbi të ardhurat personale

Bazuar në Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Neni 25, Pika 2, të ardhurat e arkëtuara nga Drejtoria Rajonale Tatimore për tatimin mbi të ardhurat personale do të ndahet me njësitë e vetëqeverisjes vendore, dhe 2% e të ardhurave nga kjo taksë kombëtare i kalon përkatësisht Bashkisë Vau dejes në llogarinë e degës së thesarit.

C.3. Te Ardhurat Nga tarifat Vendore.

Referuar ligjit 139/2015 ”Për vetëqeverisjen vendore”, neni 35/5, bashkitë krijojnë të ardhura nga tarifat vendore për: shërbimet publike që ato ofrojnë; të drejtën e përdorimit të pronave publike vendore; dhënie licencave, të lejeve, autorizimeve dhe për lëshimin e dokumenteve të tjera, për të cilat ato kanë autoritet të plotë, me përjashtim të rasteve kur përcaktohet ndryshe me ligj.

Gjithashtu bashkitë mund të krijojnë të ardhura nga veprimtaritë e tyre kulturore, sportive, dhe të tjera, të përcaktuara me ligj.


Bashkitë vendosin vetë për nivelin, mënyrën e mbledhjes dhe të administrimit të tarifave vendore, në përputhje me politikat dhe parimet e përgjithshme kombëtare të përcaktuara në ligjet në fuqi. Për vitin 2021-2023 të ardhurat e parashikuara nga tarifat përbëjnë rreth 32 % të të ardhurave të veta.

Pjeshën më të madhe në kategorinë e të ardhurave nga tarifat vendore e zënë të ardhurat nga tarifat për ofrimin e shërbimeve publike si pastrimi e largimi i mbeturinave me 42%, gjelbërimi me 6%, ndriçimi publik me afro 10%, tarifa për zënien e hapësirës publike me afro 2%, të të ardhurave nga tarifat vendore.

Tabela 13.

	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023
Te ardhura nga tarifa e pastrimit	32 686	33 667	34 667
Te ardhura nga tarifa e ndricimit	9 319	9 599	9 887
Te ardhura nga tarifa e gjelberimit	4 547	4 683	4 824

Te ardhura nga tarifat vendore



Grafiku 10. Pasha sipas zerave te ardhurave nga tarifat vendore

Kriteri bazë për vendosjen e një tarife për shërbimin publik është kostoja e tij, e cila shpërndahet dhe paguhet nga familjet dhe bizneset si kontribues dhe përfitues të këtij shërbimi.

Për të incentivuar dhe nxitur zhvillimin e disa kategorive të bizneseve, si dhe duke ju referuar nivelit ekonomiko-social sipas zonave, ngarkesa e tarifimit është shpërndarë gjithashtu duke u bazuar edhe në:

-vendndodhjen

-llojin e aktivitetit (tregti, shërbim, prodhim, profesion i lirë, fermer, transport, ndërtim, karburant, institucion, ofj, etj)

-dhe në statusin e subjektit (familjar, biznes i madh, biznes i vogël, institucion shtetëror, ambulant etj).

Parashikimi në rritje i të ardhurave nga biznesi bazohet në rritjen e njësive takapaguese e në evidentimin e kapaciteteve të reja, si dhe në shtrirjen e mëtejshme të bazës taksapaguese falë politikave fiskale lehtësuese, përmirësimit të shërbimit dhe marrëdhënies me taksapaguesin, fokusimit në zona me kapacitete të pashfrytëzuara, si dhe sensibilizimin dhe trajtimin e biznesit si partner në dhënien e shërbimeve për komunitetin.

Të ardhura nga shërbimet administrative Bashkise.

Nga tarifa për shërbimet administrative që bashkia ofron si ato të drejtorisë të zhvillimit të territorit për aplikimet për leje, kontrolle dhe verifikime, për aplikimet për AMTP-të etj si efekt i implementimit të disa tarifave të reja në paketën fiskale, planfikohet rritje prej 10% të ardhura në vit, të cilat parashikohet të mbulojnë tarifat për kostot administrative për shërbimin që i ofrohen subjekteve.

Të ardhura nga Tarifa e kontrollit të zhvillimit territorit

Kjo Tarife është një tarifë e re e cila ka disa zera mbi të cilat aplikohen tarifat. Është diktuar një rritje e kësaj tarife nga viti 2017 në 2018, prandaj janë parashikuar rritje plani në 3 vitet e ardhshme, kjo edhe si pasojë e lejimit dhe lehtësimit të procedurave për dhenie leje ndërtimi.

Të ardhura nga Tarifa për vulosje veterinare të bagëtive të therura

Zëri tarifa për vulosje veterinare të bagëtive të therura pas verifikimit të mishit të bagëtive të therura në vende të aprovuara parashikon të ardhura me rritje 7% në vit nga tarifimi për vendosje vule nga veterineri i autorizuar, si rezultat i rrijës së kërkesës dhe kontrolleve.

Të ardhura nga Tarifat e liçensimit të veprimtarive të transportit

Plani i të ardhurave nuk parashikon rritje për subjektet që pajisen me liçensën dhe çertifikatën përkatëse për transport udhëtarësh ose mallrash, për vete ose për të tretë.

Të ardhura nga Tarifa e parkimit për mjetet e licencuara dhe për vendparkime publike

Të ardhurat e planifikuara nga tarifa e parkingut për mjetet që janë pajisur me një licensë transporti, dhe një pjesë e tyre kanë vende të caktuara me sinjalistikë të veçante rrugore si taksi, mikrobuzë, autobusë etj.

Te ardhura nga Tarifa për dhënie licensë për tregtimin të naftës bruto e n/produkteve

Bazuar në VKM Nr. 970, dt 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, ky zë parashikon rritje prej 25% të ardhura viti nga subjekte me aktivitet tregtim karburanti, që do pajisen dhe ripajisjen me licensën përkatëse.

Të ardhura nga Tarifat e sektorit të pyjeve dhe kullotave

Të ardhurat e parashikuara me rritje 19 % në vitin bazohen në trendin e aplikimeve të tarifave të shërbimeve administrative që kryen sektori i pyjeve dhe kullotave.

Të ardhura nga Tarifat e shërbimeve të mbrojtjes nga zjarri

Të ardhurat e parashikuara me rritje, dhe bazohen në nivelin e tarifave të shërbimeve që kryen struktura e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit ndaj shtetasve dhe personave, juridik e fizik, vendas e të huaj, si dhe në realizimin e të ardhurave vitet e kaluara nga kjo strukturë.

Të ardhura nga Tarifa për zënie e hapësirave publike

Baza e taksës për zënie të hapësirave publike është sipërfaqja në m², e cila vihet në shfrytëzim nga individë dhe subjekte për qëllime biznesi. Taksa llogaritet si detyrim mujor i taksapaguesit. Parashikimi i të ardhurave është bërë duke ju referuar kërkesës në rritje për shfrytëzimin e hapësirave publike brenda juridiksionit të Bashkisë.

Të ardhura nga Tarifat për linjat ajrore dhe nëntokësore (Telefoni, Energji, TV Kabllor, Internet)

Baza e taksës për tarifën për linjat ajrore dhe nëntokësore (Telefoni, Energji, TV Kabllor, Internet) e cila vihet në shfrytëzim nga individë dhe subjekte për qëllime biznes për linjat ajrore ose nëntokësore është në lekë/km/vit.


Parashikimi i të ardhurave është bërë duke ju referuar kapaciteteve të hapësirave brenda juridiksionit të Bashkisë.

C.4. TE ARDHURA TE TJERA

Referuar ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 36, të ardhura nga burime të tjera janë: të ardhurat nga dhënia me qira e aseteve në pronësi të bashkisë; të ardhurat nga sekuestime dhe zhvenditje, të ardhura nga shitja e mallrave dhe shërbimeve, të ardhura nga shitja e aktiveve të qendrueshme etj.

Bashkitë krijojnë të ardhura nga veprimtaritë e tyre ekonomike, qiratë dhe shitja e pronave, interesat, gjambat, kamatvonesat etj.

Të ardhurat nga burime të tjera përbëjnë në total 16 % të të ardhurave nga burimet e veta vendore. Pjesë e rëndësishme në këtë kategori zënë të ardhurat nga dhënia me qira e aseteve të bashkisë gjambat dhe kundravajtjet administrative.



Grafiku 11. Ardhura të tjera

Të ardhura nga dhënia me qira e aseteve në pronësi të Bashkisë

Te ky zë parashikohen të ardhurat nga qira të bazuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 529, datë 8.6.2011 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar. Pasuritë që jepen me qira janë ndërtesat, trualli i lirë, trualli i lirë funksional (jo nën ndërtesë), makineritë e pajisjet dhe linjat e prodhimit.

Parashikimi i të ardhurave me 10% në vit është bërë duke ju referuar kontratave vijuese dhe kapaciteteve brenda juridiksionit të Bashkisë.

Te ardhurat nga kundrvajtje administrative/gjobat

Gjobat bazohen në ligjin Nr. 10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”:

Bazuar në Nenin 6.b, ”Shkeljet që përbëjnë kundërvajtje administrative parashikohen me akte të këshillit bashkiak, për shkelje që nuk janë parashikuar si të tilla në ligje të veçanta, që kanë lidhje me fushat e veprimtarisë së tyre në njësitë territoriale përkatëse, ku, sipas ligjit, ushtrojnë funksionet e veta”.

Bazuar në Nenin 10, “Masa e dënimit me gjobë përcaktohet nga ligji, i cili ka parashikuar kundërvajtjen administrative. Masa e dënimit me gjobë mund të jetë fikse apo e përcaktuar me kufij minimalë dhe maksimalë. Në rastet kur kundërvajtjet administrative parashikohen në aktet e miratuara nga këshilli bashkiak, masa e dënimit përcaktohet në këto akte.

Ky zë parashikon të ardhurat nga kamatvonesa për mosshlyerje detyrimi në afate ligjore nga bizneset, gjoba nga kontrole dhe inspektime tatimore, gjoba për kundrvajtje administrative që mund të vendosen nga Policia Bashkiake, nga Inspektoriati Ndërtimit Vendor etj.

Parashikimi i të ardhurave me me rritje është bërë duke ju referuar trendit të të ardhurave ndër vite kryesisht nga kamatvonesat për shlyerje pas afatit të detyrimit tatimor të bizneseve, nga gjobat e Policisë Bashkiake dhe nga gjobat e vendosura nga Inspektoriati Vendor i Mbrojtjes së Territorit.

Të ardhura nga shitja e mallrave dhe shërbimeve

Sipas përcaktimeve ligjore, aktivet që pas vlerësimit nxirren jashtë përdorimit, kur mund të përdoren si vjetërsira/mbeturina/materiale të riciklueshme, hiqen nga regjistri i aktiveve në përdorim, bëhen hyrje në magazinë dhe u shiten me ankand ndërmarrjeve që i grumbullojnë. Për zërin të ardhura nga shitja e mallrave dhe shërbimeve rritja është parashikuar me shume se vitete e kaluara.

C.5 Të ardhura nga Donacionet (sponsorizimet)

Referuar Ligjit Nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe organet e tyre kanë të drejtë të pranojnë donacione, të cilat regjistrohen në buxhetin e njësisë së vetëqeverisjes vendore. Donacionet e pranuar nga institucionet dhe ndërmarrjet në varësi apo në pronësi të njësisë së vetëqeverisjes vendore duhet të raportohen te kjo e fundit, në çastin që ato merren.

Meqënëse planifikimi i të ardhurave bazohet mbi marreveshjet për sponsorizime dhe donacione, nuk parashikohen ndër vite të ardhura nga ky zë.

D. Parashikimi bazuar në politikat fiskale


Planifikimi i të ardhurave është bërë duke u bazuar tek të dhënat aktuale, si dhe duke ju referuar me tendencë rritjeje kapacitetit të realizimit të të ardhurave ndër vite, ku synohet shtrirja dhe zgjerimi i bazës së taksapaguesve kryesisht në zonat rurale, falë krijimit të databas-it të mirëfillta në çdo njësi, politikave fiskale lehtësuese, sensibilizimit dhe ndërgjegjësimit të taksapaguesit, rritjes së efikasitetit të agjentit tatimor, krijimit të lehtësive për pagesë, rritjes së mëtejshme të kapacitetit profesional të administratës vendore, përmirësimit të shërbimit dhe marrëdhënies me taksapaguesin, si dhe krijimi i kadastres fiskale etj.

Rëndësi e veçantë i jepet edhe rritjes së transparencës, përmirësimit të klimës, dhe trajtimit të biznesit si partner bashkisë në dhënie të shërbimeve për komunitetin.

Ndryshimet ligjore se fundmi në sistemin fiskal, nga njëra anë, synojnë të lehtësojnë biznesin dhe, nga ana tjetër, rregullojnë dhe normalizojnë situatën në shumë sektorë të ekonomisë lokale. Këto ndryshime, njëkohësisht, rrisin të ardhurat e Bashkisë Vau Dejës, duke bërë të mundur ofrimin e më shumë shërbimeve me një cilësi më të lartë.

1. **Taksa mbi pasuritë e paluajtshme**, ka ndryshuar me ligjin Nr. 106/2017, date 30.11.2017, dhe VKM nr. 132, date 7.3.2018, për shtëpitë e banimit, është rritur 2-fish, me përjashtimin e vetëm se do të aplikohet ulja me 30% për njësitë administrative malore Temal, Shllak dhe Vig- Mnele, ndersa për sa i përket ndërtesave për tregti, kjo taksë ka pesuar zbritje afro 50%.
2. Me propozimin e Ministrisë së Financës, është vendosur **një taksë mbi truallin**, e cila është në nivele simbolike, ku individët do të paguajnë vetëm 0,14 lek/m² në vit ndërsa bizneset vetëm 12 lekë/m² në vit.
3. **Taksa e fjetjes në hotel** deri më sot është llogaritur si 5% e çmimit për çdo natë të shpenzuar në hotel. Me ndryshimet ligjore, taksa e fjetjes për hotelet me 4-5 yje do të jetë vetëm **105 lekë** për çdo natë, ndërsa për bujtinat, motelet etj do të jetë vetëm 35 lekë për çdo natë.
5. **Taksa e ndikimit në infrastrukturë** ka ndryshuar dhe nuk do të llogaritet më në kufijtë 1% deri në 3% të vlerës së investimit, por në kufijtë në 4-8% të çmimit të shitjes.
6. **Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme** mbetet ne nivelin ekzistues: 100 Lek/m² për ndërtesat e banimit, nga 300 Lek/m² për ndërtesat për tregti dhe shërbime dhe 200 Lek/m² për ndërtesat e tjera.
Ndërkohë, për njësitë administrative Bushat, Hajmel, Temal, shllak dhe Vig - Mnele do të aplikohet niveli sipas ligjit, pra pekaesisht 100 Lek/m² për ndërtesat e banimit, 300 Lek/m² për ndërtesat për tregti dhe shërbime dhe 200 Lek/m² për ndërtesat e tjera .
7. Taksa e tabelës për tabelat identifikuese deri në 2 m² kjo taksë do të jetë zero, pra do të shfuqizohet. Cilido që ka një biznes dhe dëshiron ta identifikojë atë nuk do duhet t'i paguajë Bashkisë as edhe një qindarkë. Për tabelat nga 2 m² deri ne 10 m² është sipas klasifikimit të tyre, dhe mbi 10 m² taksa e tabelës vjen duke u ulur.
8. A.3 Trendi i rritjes së të ardhurave.

Për periudhën 2021-2023 të ardhurat në total nga tarifat vendore parashikohet të kenë 10 % ne vitin 2021 kundrejt vitit 2020 dhe me rreth 10 % rritje ne vitin 2022 kundrejt vitit 2021 dhe kjo bazuar kryesisht tek rritja e numit të bizneseve, shtrirja e mëtejshme e bazës takspaguese falë politikave fiskale lehtësuese, përmirësimit të shërbimit dhe marrdhënies me takspaguesin, fokusimit në zona me kapacitete të pashfrytëzuara, si dhe sensibilizimin dhe trajtimin e biznesit si partner në dhënien e shërbimeve për komunitetin.



Grafiku 12 ardhurat e veta ne total

Plani i të ardhurave bazohet tek harmonizimi dhe trajtimi sa më drejtë me taksa dhe tarifa për gjithë gamën e larmishme të bizneseve e familjeve, me aktivitete dhe vendodhje në zona me funksione të ndryshme. Ai mundëson dhe siguron pëmbushjen e funksioneve të shumta të bashkisë ndaj qytetarëve të saj, duke realizuar njëkohësisht objektivat madhorë në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm të të gjithë zonës.

E. Analiza e risqeve dhe masat për përballimin e tyre.

Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “ Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, përcakton parimet, rregullat, procedurat, strukturat administrative dhe metodat për funksionimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit në njësitë e sektorit publik të Republikës së Shqipërisë, si dhe përgjegjësitë menaxheriale për planifikimin, zbatimin, kontrollin e buxhetit, kontabilitetin dhe raportimin. Ligji përmban koncepte dhe përgjegjësi të reja për menaxhimin e riskut në institucionet publike.

Menaxhimi i riskut përmban identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ato ngjarje apo situata të mundshme që kanë efekt të dëmshëm mbi pëmbushjen e objektivave të njësisë publike dhe kryhet për të dhënë siguri të arsyeshme se këto objektiva do të realizohen.

Risku matet sipas efektit të tij dhe shkallës së probabilitetit të ngjarjes, dhe nje nder ngjarjet eshte Pandemia e (Covid-19), e cila deri tani ka sjellje nje renie te te ardhurave krahasuar me te njejten periudhe te vitit kaluar.

Identifikimi dhe menaxhimi i riskut mundëson strukturat drejtuese në çdo njësi në kryerjen e detyrave dhe përgjegjësi që kanë për realizimin e aktivitetit në to. Çdo drejtues është i vetëdijshëm se risku do të ekzistojë dhe nuk do të eliminohet kurrë tërësisht. E rëndësishme është që risku të menaxhohet në mënyrë efektive.

Strategjia e riskut përkufizohet si qasja e njësisë për menaxhimin e riskut e pasqyruar në politikat e nivelit të lartë të njësisë publike dhe më tej. Ajo përcakton mënyrën se si sillet njësia ndaj risqeve dhe vendos kuadrin e përgjithshëm të procesit të menaxhimit të riskut. Strategjia e riskut të njësisë duhet të përcaktojë në mënyrë të qartë strukturat përgjegjëse për menaxhimin, monitorimin dhe raportimin e risqeve. Për risqet që janë cilësuar më të lartat (më kritiket), duhet të hartohet një plan afat-gjatë veprimi.

Për realizimin e të ardhurave të veta vendore, njëkohësisht duke ruajtur tendencën për përmirësimin e politikave dhe strategjive incentivuese e zhvilluese të ekonomise lokale, është hartuar strategjia për menaxhimin e riskut duke kaluar në këto etapa:

- a) Identifikimi i objektivave
- b) Identifikimi i risqeve të jashtme dhe të brendshme.
- c) Analiza dhe vlerësimi i çdo risku (sipas probabilitetit dhe impaktit).
- d) Marrja e masave të metejshme, për pakësimin apo reduktimin e riskut.
- e) Paraqitja e të gjithë konkluzioneve të arritura
- f) Krijimi i hartës së riskut, grupimi në bazë të impaktit dhe probabilitetit të ndodhjes së tyre, duke treguar në këtë mënyrë ato fusha të veprimtarisë së njësisë, ndaj të cilave duhet të regohet vëmendje e veçantë.
- g) Monitorimi dhe raportimi.
- h) Hartimi i planit të veprimit për zbatimin e strategjisë.

Regjistri i Riskut

Objektivat janë planifikimi buxhetor, llogaritja, analizimi dhe kontabilizimi i burimeve financiare të të ardhurave të veta, ndjekja e politikave dhe strategjive sensibilizuese, mbështetese dhe zhvilluese për krijimin e të ardhurave, zbutjes së informalitetit, rritjes së konkurrencës së ndershme, si dhe administrimi i marëdhëniet me taksapaguesit dhe shërbimi ndaj tij.

Tabela 15

1	2	3	4	5	6	7	8	9
Nr	Përshkrimi i riskut	Risku para kontrolit	Kontrollet ekzistuese	Risqet pas kontrolleve ekzistuese	Nevoja për kontrolle të metejshme	Veprime për të adresuar boshlleqet	Zotëruesi i riskut	Ndryshimet në risk që nga detyra e fundit (përkeqësohet => përmirësohet <= i pandryshuar =)
1.	Mungesa e informacionit në terren	mesëm -ulët	Monitorime në terren nga inspektorët e terrenit	ulët-ulët	po	Përgatitja e planit të punës për evidentim	Spektori i ardhurave	Përmirësuar
2	Mungesa e informacionit nga Z.R.Rr.Pasurisë Paluajtshme	mesëm - mesëm	Kërkesa shkresore për informacion	Mesëm - mesëm	Po	Rritja e bashkepunimit me Z.R.Rr.Pasurisë Paluajtshme	Zyra Rajonale e Regjistrimit të pasurive të Paluajtshme	Përmirësuar
3	Mungesa e informacionit nga QKR-ja	ulët ulët	Kërkesa shkresore për informacion	ulët-ulët	po	Bashkepunim me QKR-ne	QKR dhe Spektori i ardhurave	Përmirësuar
4	Dokumenacioni i plotë arkivor	ulët ulët	Pasurimi me dokumentacionin pronësor	ulët-ulët	Po	Pasurimi gjatë dheniës së shërbimit ndaj taksapaguesit	Spektori i ardhurave	Pandryshuar
1	Mungesa e informacionit në Njësitë Administrative	mesëm - ulët	Monitorime në terren Njësitë Administrative	ulët - ulët	po	Grupe të zgjeruara për evidentimin e taksapaguesve	Njësitë Administrative dhe Spektori i Ardhurave	Përmirësuar
2	Mungesa e informacionit nga	mesëm -	Kërkesa shkresore për informacion	mesëm mesëm	Po	Rritja e bashkepunimit	Zyra Rajonale	Përmirësuar

	Z.R.Rr.Pasurisë Paluajtshme	mesëm				t me Z.R.Rr.Pasurive	e Rregjistrimit të pasurive të paluajtshme	
3	Mungesë informacioni për tokën bujqesore	mesëm - mesëm	Monitorime në terren nga Njësitë Administrative	mesëm - mesëm	po	Bashkepunim me Drejtorinë e bujqësisë	Drejtoria e Bujqësisë dhe Sektori ardhurave	Pandryshuar
4	Dokumenacion bazues për taksim	mesëm - mesëm	Pasurimi me dokumentacion I pronësisë	mesëm - mesëm	Po	Pasurimi gjatë dhenies së shërbimit ndaj taksapaguesit	Zyra me një ndalesë dhe Sektori ardhurave	Pandryshuar
1	Ndjekja e masave shtrënguese	mesëm - mesëm	Njoftime në terren dhe me postë	mesëm - mesëm	po	Përgatija e planveprimit	Sektori i ardhurave Masave shtrenguese	Pandryshuar
2	Rakordim i shpejtë i pagesave	ulët - ulët		ulët- ulët	jo	Plan veprimi për rakordimin e të ardhurave	Sektori i ardhurave	Përmirësuar
3	Përmirësimi i marëdhënies taksapagues – taksambledhës	mesëm -ulët	Sensibilizim dhe njoftime të afateve në media, propozim për taksa të përballueshme dhe incentive, ndarje e detyrimeve në këste, etj.	ulët- ulët	jo	Trajtimi dhe interpretimi i kërkesave nga subjektet	Sektori i ardhurave specialisti i shërbimit ndaj taksapaguesit	Përmirësuar
1	Realizimi i të ardhurave nga bizneset	ulët ulët	Analiza mujore sipas zërave	ulët- ulët	po	Shqyrtimi i zërave sipas ecurisë	Sektori i ardhurave	Pandryshuar
2	Realizimi i të ardhurave nga familjet	mesëm -ulët	Analiza sipas Njësive Administrative	ulët- ulët	po	siShqyrtimi i pas ecurisë	Sektori ardhurave	Pandryshuar per shkak pandemise
1	Dhënia e informacionit për taksapaguesit	mesëm -ulët	Dhënie e shërbimit pranë sportleve	ulët- ulët	jo	Shqyrtimi i kohës që konsumon tatimpaguesi	Sektori i ardhurave dhe Zyra me Një ndalesë	Përmirësuar
2	Llogaritje e shpejtë	ulët ulët	Përfshirje e llogartjes së detyrimit në sistemin e kopmjuterizuar	ulët- ulët	po	Shqyrtimi i nevojës së tatipaguesve	Programuesit e Sistemit dhe Sektori i ardhurave llogaritjes së detyrimit	Pandryshuar
3	Evidentim i shpejtë i pagesave	mesëm -ulët	Kontabilizim i shpejtë i të ardhurave	ulët- ulët	jo	Monitorimi i kohës për emetimin e evidencave	Sektori i ardhurave	Përmirësuar
1	Përditësim me standartet e reja ligjore	ulët ulët	Shyrtimi i njohurive dhe evidentimi i ndryshimeve	ulët- ulët	po	Krahasimi dhe diskutimi periodik mbi njohuritë	Sektori Ardhurave	Pandryshuar
2	Njohuri mbi sistemet e fundit informatike të instaluar	ulët ulët	Shqyrtimi dhe krahasimi nevojat e me programeve	ulët- ulët	po	Kontrolle periodike mbi nevojën për njohuritë	Sektori Ardhurave	Pandryshuar
3	Njohje me eksperiencia	mesëm - ulët	Trainime dhe dikustime mbi to	ulët- ulët	po	Diskutime dhe konstatime	Ardhurave Sektori	Përmirësuar

të ngjashme dhe trainime profesionale								
---------------------------------------	--	--	--	--	--	--	--	--

I. Tavanet përfundimtare të shpenzimeve të PBA për Vitet 2021-2023

Percaktimi i taveve përfundimtare të shpenzimeve të PBA për vitet 2021-2023, është realizuar bazuar në nenin 9 , 34 dhe 41 të ligjit Nr.139/2015“Për vetëqeverisjen vendore“, i ndryshuar, të ligjit Nr.9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar , ligjin nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar , nenin 37 të ligjit 68/2017 date 27.4.2017 “ Per financat e veteqeverisjes vendore “, udhëzimit të Ministrise se Financave dhe Ekonomisë nr. 23 date 30.07.2018 “ Per procedurat standarte te pergatitjes se programit buxhetor afatmesem te NjQV” , udhëzimin plotësues të Ministrise se Financave dhe Ekonomisë nr. 10 date 28.02.2020“ Per pergatitjen e programit buxhetor afatmesem vendor 2021-2023” dhe shtojcat plotësuese (Shtojcat e programit buxhetor afatmesem 2021-2023 nga 1-5 si informacion mbi nivelin e transfertës së pakushtëzuar dhe specifike për njësitë e vetëqeverisjes vendore, formati I pergatitjes se relacionit shoqerues se programit buxhetor afatmesem 2021-2023 formati per treguesit orientues te performances per cdo program ,Grupi per menaxhimin Strategjik / Ekipi I Menaxhimit te programit si dhe roli I tyre , treguesit makroekonomik e fiskale , pema e programit si dhe Instrumenti i planifikimit të programit buxhetor afatmesëm për njësitë e vetëqeverisjes vendore), me shkresë hyrëse në Bashkinë Vau Dejës nr prot. 4491/1 datë 04.03.2019, udhëzimit plotësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 27 date 10.07.2020 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesem vendor 2021-2023 ” me shtojcat perkatese 1-5, derguar e plote me e-mail date 15.07.2020 nga MFE. Duke u bazuar dhe në ligjin nr 137 date 16.11.2020 “Per buxhetin e vitit 2021” mbi detajimin e fondeve per tranferten e pakushtezuar te pergjithshme dhe tranferten e pakushtezuar sektoriale per vitin 2021.

Puna ka percaktuar veprimtarine e punes të Ekipeve të Menaxhimit të Programit (EMP), si me poshte vijon:

- Propozimin e strukturës së programeve duke siguruar perfshirjen brenda një programi shpenzimesh të funksioneve kryesore të njësisë.
- Shpërndarjen tek çdo Ekip i Menaxhimit të Programit të udhëzimeve të brendshem të nënshkuara nga titullari në lidhje me zbatimin e procedurave të programit buxhetor afatmesëm.
- Diskutimin me drejtuesit e programeve për dokumentin e risqeve të paraqitur prej tyre dhe përcaktimin e risqeve prioritare për t'u diskutuar në Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS).
- Nënshkrimin e të gjithë raporteve të përgatitjes së kerkesave buxhetore për përdorim të brendshëm të njesise në lidhje me Rishikimin e Politikës së Programit dhe Planifikimin e Shpenzimeve të Programit.
- Prezantimin tek Kryetari i Grupit të Menaxhimit Strategjik të të gjithë dokumentacionit të kerkesave buxhetore.

II. Burimet e Financimit

Ne baze te udhezimit plotesues nr. 27 date 10.07.2020“ *Per pergatitjen e programit buxhetor afatmesem vendor 2021-2023*” si dhe vendimit te Keshillit Bashkiak nr. 11 date 26.2.2020 me objekt “ *Per miratimin e raportit te vlersimeve dhe parashikimeve afatmesme te te ardhurave te Bashkise Vau Dejës per vitet 2021-2023*” burimet e financimit per PBA 2021-2023 jane si me poshte:

(000/lekë)

Nr.	Burimet e financimit	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023
1	Transferte e pakushtezuar	224,557	226,907	243,949
2	Të ardhurat e veta vendore	186,854	192,460	198,233
3	Transferta pakushtezuar sektoriale	111,825	111,825	111,825
4	Transferta e kushtëzuar	300,366	300,366	300,366
TOTALI		823,602	831,558	854,373

II.2.1 Te Ardhurat e Veta.

(000/lekë)

Vitet	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023
Te ardhurat e veta	186,854	192,460	198,233

II.2.2 Transferta e pakushtezuar.

Ne baze te udhezimit te Ministrise se Financave dhe Ekonomise ndarja e transfertes së pakushtezuar sipas njësive të vetëqeverisjes vendore, për periudhën 2021-2023, bazohet në formulë, sipas përcaktimeve të nenit 24 të ligjit nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”. Të dhënat sipas kriterit të popullsisë, të dëndësisë së popullsisë, të numrit të nxënësve, taksat e përdorura për ekualizimin janë ato të përdorura në ndarjen e transfertes së pakushtezuar në buxhetin e vitit 2020. Sipas udhezimitplotesues nr. 27 date 10.07.2020“ Per pergatitjen e programit buxhetor afatmesem vendor 2021-2023” me shtojcat perkatese 1-5 , per Bashkine Vau Dejës transferta e pakushtezuar eshte parashikuar si me poshte :

(000/lekë)

Vitet	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023
Transferte e pakushtezuar	224,557	226,908	243,949

Sqarojme se sipas udhezimit plotesues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomise nr. 27 date 10.07.2020 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesem vendor 2021-2023 ” transferta e pakushtezuar per vitin 2021 eshte 4.3% me e ulet se transferta e pakushtezuar e akorduar per vitin 2020 ne kundershtrim me nenin 23 pika 3 te ligjit 68/2017 date 27.4.2017 “ Per financat e veteqeverisjes vendore ” qe thote: “Në çdo rast, transferta e pakushtezuar nuk mund të jetë më e vogël se shuma totale e ndarë në vitin e mëparshëm buxhetor”.

Kemi ndryshim te tavaneve perfundimtare te PBA 2021-2023 sepse kemi renie te transfertes se pakushtezuar per te tre vitet e PBA 2021-2023 per kete faze kundrejt transfertes se pakushtezuar te njoftuar me udhezimin nr. 10 date 28.02.2020“ Per pergatitjen e programit buxhetor afatmesem vendor 2021-2023” .

Diferencen e transfertes se pakushtezuar te planifikuar me pak per vitin 2021 me udhezimin plotesues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomise nr. 27 date 10.07.2020 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesem vendor 2021-2023 ” kemi perdorur fondet e trashguara nga viti 2019 te miratuar me VKB nr.92 datë 24.12.2019 “Për miratimin e e buxhetit te vitit 2020 dhe programit buxhetor afatmesem perfundimtar 2020-2022,numrin e punonjesve per Bashkine Vau Dejës” me burim financimi nga transferta e pakushtezuar, transferta e pakushtezuar sektoriale dhe te ardhurat.

II.2.3 Transferta e pakushtezuar sektoriale

Sipas udhezimit transferta pakushtezuar sektoriale, për funksionet e transferuara në nivel vendor për periudhën 2021-2023, bazohet në Kuadrin Makroekonomik e Fiskal të miratuar.

Ndarja e transfertës pakushtezuar sektoriale sipas njësive të vetëqeverisjes vendore për periudhën 2021-2023 do të jetë në të njëjtat nivele me ndarjen e transfertës së miratuar me buxhetin e vitit 2021, Ne zbatim të ligjit nr 9936 date 26.6.2008 "Per menaxhimin e Sistemit Buxhetor ne Republikën e Shqiperise" i ndryshuar dhe ligjit nr 137 date 16.11.2020 "Per buxhetin e vitit 2021" transfertat jane si me poshte:

(000/lekë)

Transferta e Pakushtezuar Sektoriale	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023
Konviktet e arsimit parauniversitar	8,720	8,720	8,720
Arsimi parauniversitar	2,362	2,362	2,362
Arsimi parashkollor	38,244	38,244	38,244
Mbrojtja nga zjarri dhe shpëtimi	18,588	18,588	18,588
Mbrojtja Sociale	19,190	19,190	19,190
Administrimi i pyjeve	6,677	6,677	6,677
Rrugët rurale	5,661	5,661	5,661
Ujitja dhe Kullimi	12,383	12,383	12,383
TOTALI	111,825	111,825	111,825

II.2.4 Transferta e kushtezuar.

Transferta e kushtëzuar përbëhet nga fondet e deleguara për mbulimin e shërbimit të Gjendjes Civile, Qendrës Kombëtare të Biznesit, fondet për mbështetje me ndihmë ekonomike për familjet në nevojë, për Përsone me Aftësi të Kufizuar, fondet për ushqimet e nxënësve konviktore të shkollave të mesme profesionale.

Struktura e punonjesve të gjendjes civile është sipas VKM nr 1299, date 16.12.2009, me 6 punonjes, ku mbulohen 3 zyra të gjendjes civile, të shpërndara në qendër të Bashkisë dhe NJA (ish komuna). Pagesa e punonjesve bëhet në përputhje me Vendim i KM, Nr.187, Dt.08.03.2017.

Struktura e punonjesve të shërbimit të QKB-se në bashki është në përputhje me numrin e sporteleve të hapura pranë njësive të vetëqeverisjes vendore 2 punonjes. Kjo në zbatim të nenit 11 të ligjit nr 9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit" të ndryshuar.

Nga transfertat e kushtëzuar financohen nxënësit konviktore të shkollave të mesme profesionale, që trajtohen me kuote ushqimore, nxënësit që trajtohen me kuote financiare .

Peshën më të madhe të shpenzimeve që mbulohen me transfertat e kushtëzuar e zënë transferimet individuale për pagesë përsonat me aftësi të kufizuar , invaliditeti dhe ndihmë ekonomike dhe konkretisht për vitin 2021 në shumën 288,666 mijë leke , në vitin 2022 në shumën 288,666 mijë leke dhe në vitin 2023 në shumën 288,666 mijë leke. Pra mesatarisht 96% të transfertes së kushtëzuar.

Meqenese ne udhezimin e MFE nr. 10 date 28.2.2020 dhe udhezimin e MFE nr.27 date 10.07.2020 , nuk ka instruksione specifike per llogaritjen e 4 % te fondeve per mbrojtjen civile, Në transfertën e kushtëzuar është përfshirë llogaritja prej 4% . Fondet janë parashikuar në programin 03280. Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile.Konkretisht ne vitin 2021, lek 22,779, ne vitin 2022 lek 22,779 dhe ne vitin 2023 lek 22,779.

(000/lekë)

Vitet	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023
Transferta e kushtëzuar	300,366	300,366	300,366

III. Programet dhe Tavanet

Sipas udhezimit Plotesues nr.10 date 28.02.2020“ Per pergatitjen e programit buxhetor afatmesem vendor 2021-2023” dhe shtojcat bashkangjitur ketij udhezimi si dhe udhezimit plotesues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomise nr. 27 date 10.07.2020 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesem vendor 2021-2023 ” me shtojcat perkatese 1-5, struktura e programeve te buxhetit vendor Vau Dejës do tëjete si më poshtë:

Nr	Funksioni	Nr	Nenfunksioni	Nr	Programi
1	SHËRBIME TË PËRGJITHSHME PUBLIKE	011	Organet ekzekutive dhe legislative, çështjet financiare, fiskale, dhe çështjet e brendshme	01110	Planifikim menaxhim administrim
				01170	Gjendja civile
3	RENDI DHE SIGURIA PUBLIKE	031	Shërbimet policore	03140	Shërbimet e Policise Vendore
				03280	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile
4	CESHTJE EKONOMIKE	041	Çështje të përgjithshme ekonomike, tregtare dhe të punës	04130	Mbeshtetja per zhvillimin e konomik
				04160	Sherbimi I tregjeve, akreditimi dhe inspektimi
		042	Bujqësia, pyjet, peshkimi dhe gjuetia	04220	Sherbimet bujqesore, inspektimi, siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatoreve
				04240	Menaxhimi i infrastructures se ujitjes dhe kullimit
				04260	Administrimi i pyjeve dhe kullotave
		045	Transporti	04520	Rrjeti rrugor rural
		047	Industri të tjera	04570	Transporti publik
				04740	Projekte zhvillimi
04760	Zhvillimi i turizmit				
5	MBROJTJA E	051	Menaxhimi i mbetjeve	05100	Menaxhimi i mbetjeve

	MJEDISIT	052	Menaxhimi i ujërave të zeza	05200	Menaxhimi i ujërave të zeza dhe kanalizimeve
6	STREHIMI DHE KOMODITETET E KOMUNITETIT	061	Urbanistika	06140	Planifikimi urban vendor
		062	Zhvillimi i komunitetit	06260	Sherbimet publike vendore
		063	Furnizimi me ujë	06330	Furnizimi me uje
		064	Ndriçimi i rrugëve	06440	Ndricim rruges
7	SHENDETESIA	072	Shërbimet e kujdesit paresor	07220	Sherbimet e kujdesit paresor
8	ARGETIMI KULTURA DHE FEJA	081	Shërbimet rekreative dhe sportive	08130	Sport dhe argetim
		082	Shërbimet kulturore	08220	Trashegimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore
9	ARSIMI	091	Arsimi parashkollor dhe bazë	09120	Arsimi bazë perfshire arsimin parashkollor
		092	Arsimi parauniversitar	09230	Arsimi i mesem i pergjithshem
				09240	Arsimi profesional
10	MBROJTJA SOCIALE	104	Familje dhe fëmijët	10430	Kujdesi social per familjet dhe femijet
		106	Strehimi	10661	Strehimi social

FUNKSIONI 1: SHËRBIME TË PËRGJITHSHME PUBLIKE

Nënfunkcioni 011: Organet ekzekutive dhe legjislative, për çështjet financiare dhe fiskale, çështjet e brendshme

Vështrim i përgjithshëm		
Zhvillimi i njësisë, menaxhimi i financave të njësisë së vetëqeverisjes vendore, të burimeve të tjera si dhe të burimeve njerëzore, funksionimi i proceseve të përgjithshme të brendshme dhe komunikimi me publikun. Shërbime në mbështetje të kryetarit të njësisë së vetëqeverisjes vendore ose të këshillit;		
Kodi i programit	Emri i Programit	Përshkrimi i programit
01110	Planifikim, menaxhim	<ul style="list-style-type: none"> Zhvillimi dhe zbatimi i politikave të përgjithshme për personelin;

Nr. 1	<p>Relacion mbi shpenzimet e Këshillit Bashkiak</p> <p>Projekti: P01110.O1.A1. Mbështetje për funksionimin e organeve të zgjedhura vendore (Këshilli i Bashkisë dhe Kryetaret e Fshatrave)</p>	<p>Funksioni 1: Shërbime të Përgjithshme Publike</p> <p>N/Funksioni 011: Organet ekzekutive dhe legjislative, për çështjet financiare dhe fiskale, çështjet e brendshme.</p> <p>Llojet e programit: 01110. Planifikim Menaxhim dhe Administrim</p>
-------	--	---

a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:

i. Situata

- Për mbështetjen e funksionimit të organeve të zgjedhura vendore ku përfshihen Këshilli i Bashkisë Vau Dejës me 31 anëtarë dhe 46 kryetarë të fshatrave të Njesive Administrative në territorin e Bashkisë Vau Dejës, zbatohet VKM nr. 177, datë 8.3.2017.
- Për mbështetjen e aktiviteteve të Këshillit Bashkiak sipas Planit të Aktiviteteve. (bashkëngjitur)
- "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin. nr.165 datë 02.03.2016" Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore", i cili rregullon efektet e masës së shpërblimit për anëtarët e Këshillit të Bashkisë Vau Dejës dhe kryetarët e fshatrave.
- Shpërblimi i anëtarëve të Këshillit dhe kryetarëve të fshatrave kryhet në formën e honorareve dhe kompensimeve në përputhje me aktet ligjore në fuqi.

ii. Synimi i projektit

- Mbështetja e funksionimit të Këshillit i Bashkisë Vau Dejës dhe strukturave komunitare në territorin e Bashkisë Vau Dejës.
- Zbatimin e planit të aktiviteteve të Këshillit Bashkiak për vitin 2021 (bashkëngjitur)
- Garantimi i masës së shpërblimit të miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak për anëtarët e tij.
- Sigurimi i mbështetjes me shërbimeve operative për funksionimin e Këshillit Bashkiak, për aktivitetet e planifikuara sipas planit bashkëngjitur.
- Për të gjitha aktivitetet e planifikuara do të zbatohet ligji "Për Menaxhimin financiar dhe kontrollin financiar", ligji "Për prokurimin publik", që nga planifikimi, specifikimet teknike, rezultatet, prokurimi, kontrata, zbatimi, monitorimi dhe kontrolli.

iii. Aktivitetet kryesore të projektit

- Mbledhjet e Këshillit Bashkiak
- Mbledhjet e Komisioneve të Përhershme të KB
- Shqyrtim i raportit për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave
- Informimi i komunitetit dhe transparenca e veprimtarisë së Këshillit Bashkiak, llogaridhënia e Këshillit Bashkiak; Prezantim i Raportit Vjetor të punës së Këshillit Bashkiak.
- Pjesëmarrje në aktivitete të rëndësishme vendore, konferenca, dhe aktivitete me interes për KB

- Miratimi i raportit të vlerësimit të të ardhurave dhe shpenzimeve
- Shqyrtim i tavaneve përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm në nivel programi
- Vizite studimore në NjQV brenda vendit dhe jashte vendit
- Hartim i Planit të Monitorimit të: Shërbimit të Pastrimit / Transportit / Ndricimit / Shërbimeve sociale / Arsimit baze dhe parashkollor/ Investimeve publike etj; Kërkesë drejtuar Bashkisë për të raportuar në lidhje me këto Shërbime / Monitorim dhe hartimi i Raportit nga Komisioni / Raportimi në Këshillin Bashkiak
- Paraqitja e raportit për aktivitetin financiar dhe zbatimin e buxhetit vjetor të vitit paraardhës i cili duhet të jetë i krahasueshëm me planin e buxhetit vjetor
- Analize/Monitorim i punës së ndërmarrjes Ujësjiellës/Kanalizime
- Pjesëmarrje në trajnime për Sekretariatit e KB dhe keshilltaret
- Informimi i komunitetit dhe transparenca e veprimtarisë së Këshillit, llogaridhënia e këshillit - Promovim i Procedurave të Ankesave, Kërkesave, Peticioneve dhe Nismave Qytetare
- Takimi në Forumin e Shoqërisë Civile dhe Rinisë; Promovim i Peticioneve dhe Iniciativave qytetare
- Konsultime me komunitetin për Shërbimet e pastrimit, për Shërbimin të Pastrimit, të transportit, Ndricimit, të Shërbimeve sociale, të Arsimit baze dhe parashkollor/ Hartim i raportit të degjësive/ Kërkesë drejtuar Bashkisë në mbledhjen e keshillit për të reflektuar shqetësimet e qytetarëve në buxhet.
- Miratimi i buxhetit vjetor dhe PBA/ Miratimi i paketës fiskale/ Miratimi i prioritetëve të investimeve në bashki
- Shpenzimet e përgjithshme që përpunohen me kalendarin e miratuar të aktiviteteve të Këshillit dhe përfshihen në buxhetin e përgjithshëm për shpenzimet administrative janë sa më poshtë:

b) Rezultatet që prisni

- Funksionimi sipas ligjit i Bashkisë Vau Dejës si rezultat i miratimit në kohë të të gjithë projekt akteve të paraqitura në mbledhjet e Këshillit Bashkiak. Miratimi i raportit për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave/ Ardhurave dhe shpenzimeve.
- Komuniteti i informuar si rezultat i transparencës dhe llogaridhënies për veprimtarinë e Këshillit Bashkiak.
- Keshilli Bashkiak aktiv dhe pjesëmarrjes në aktivitete të rëndësishme vendore, konferenca, dhe aktivitete me interes për KB
- Raporti i vlerësimit të të ardhurave dhe shpenzimeve i miratuar.
- Tavanet përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm në nivel programi të shqyrtuara dhe të miratuara
- Shërbimit të Pastrimit / Ndricimit / Shërbimeve sociale / Arsimit baze dhe parashkollor/ Investimeve publike të monitoruara dhe të përmirësuara;

- Ndërmarrja Ujës-jellës/Kanalizime te analizuar/monitoruar.
- Aftesite e Sekretariatit e KB dhe keshilltareve te rritura dhe te permiresuara.
- Komuniteti dhe transparenca e veprimtarisë së Këshillit te permiresuara- Procedurat e Ankesave, Kerkesave, Peticioneve dhe Nismave Qytetare te promovuara.
- Forumi i Shoqerise Civile dhe Rinise I informuar per punen e keshillit; Promovimi i Peticioneve dhe Iniciativave qytetare I kryer.
- Komuniteti i konsultuar per Sherbimet e pastrimit, per Sherbimin te Pastrimit, Ndricimit, te Sherbimeve sociale, te Arsimit baze dhe parashkollor.
- Buxheti vjetor dhe PBA te miratuar/ Paketa fiskale e miratuar/ Prioriteve e investimeve ne bashki te miratuar.
- Komuniteti I Bashkise Vau Dejës i mireinformuar per buxhetin e Bashkise dhe aktivitetin e Keshillit Bashkiak ne media vendore dhe online.

c) Aktorët e mundshëm

d) Kontributet e mundshme në projekt

- Komisioni i financave, buxhetit, dhe asetëve publike
- Sekretariati i Keshillit Bashkiak
- Drejtorja e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse
- Drejtorja e Financës
- Njësitë Administrative
- Institucioni qe ndjek shpenzimet: Bashkia Vau Dejës

Bashkia Vau Dejës

e) Shpenzimet e llogaritura

Shpenzimet për çdo aktivitet 2021		Totali (mije lekë)	Nga kjo:				
			Pa ga	Siguri me	Operati ve	Transfe rime	Kapit ale
A.1	Shpenzime kompensimi Anëtarë Këshilli Bashkiak 10% e pagës së Kryetarit (31 anëtarë)	4,526			4,526		
A.2	Honorare Kryepleq (46 kryepleq)	4,670			4,670		
A.3	Ekspertizë, konsulencë për këshillin bashkiak	600			600		
A.4	2(dy) Specialist mbështetës sekretariat	XX	Xx	xx			
	Shuma	9.832			9.832		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2022		Totali (mije lekë)	Nga kjo:				
			Pa ga	Siguri me	Operati ve	Transfe rime	Kapit ale
A.1	Shpenzime kompensimi Anëtarë Këshilli Bashkiak 10% e pagës së Kryetarit (31 anëtarë)	4526			4526		
A.2	Honorare Kryepleq (46 kryepleq)	4670			4670		
A.	Ekspertizë, konsulencë për	1,000			1,000		

3	këshillin bashkiak						
A. 4	2(dy)Specialist mbështetës sekretariat	XX	Xx	xx			
	Shuma	10232			10232		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2023		Totali (mije lekë)	Nga kjo:				
			Pa ga	Siguri me	Opera tive	Transfe rime	Kapit ale
A. 1	Shpenzime kompensimi Anëtarë Këshilli Bashkiak 10% e pagës së Kryetarit (31 anëtarë)	4526			4526		
A. 2	Honorare Kryepleq (46 kryepleq)	4670			4670		
A. 3	Ekspertizë, konsulencë për këshillin bashkiak	1,000			1,000		
A. 4	2(dy)Specialist mbështetës sekretariat	XX	Xx	xx			
	Shuma	10232			10232		
f) Periudha e zbatimit Janar 2021 – Dhjetor 2023		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Komisioni i financave, buxhetit, dhe asetëve publike Sekretariati I Keshillit Bashkiak Drejtoria e Finances Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse Institucioni likujdues: Bashkia Vau Dejës					

Sekretari Këshillit

Ardian Çelepija

Kryetari Këshillit

Mark Bisha

Muaji	FUSHA VENDORE
Janar	Mbledhje e Keshillit Bashkiak
	Mbledhje e komisioneve te perhershme te K.B
	Shqyrtim I raportit per vleresimet dhe parashikimet afatmesme te te ardhurave
	Informimi I komunitetit dhe transparenca e Keshillit Bashkiak,llogaridhenia e keshillit Bashkiak,prezantim I raportit vjetor te punes se Keshillit Bashkiak.
	Pjesmarrje ne aktivitete te rëndesishme vjetore,konferenca dhe aktivitete me interes per K.B
Shkurt	Mbledhje e Keshillit Bashkiak
	Mbledhje e komisioneve te perhershme te K.B

	Pjesmarrje ne trajnime per sekretariatin e K.B
	Pjesmarrje ne aktivite te rendesishme vjetore,konferenca dhe aktivite me interes per K.B
Mars	Mbledhje e Keshillit Bashkiak
	Mbledhje e komisioneve te perhershme te K.B
	Miratimi I raportit te vleresimit te te ardhurave dhe shpenzimeve
	Shqyrtimi I tavaneve pergaditore te shpenzimeve te programit buxhetor afatmesem ne nivel programi.
	Vizite studimore ne NJQV brenda vendit
	Pjesmarrje ne aktivite te rendesishme vjetore,konferenca dhe aktivite me interes per K.B
Prill	Mbledhje e Keshillit Bashkiak
	Mbledhje e komisioneve te perhershme te K.B
	Ndryshim Buxheti
	Hartim I Planit te Monitorimit te: Sherbimit te pastrimit,Sherbimeve sociale,Arsimit baze dhe parashkollor,Investimeve publike etj.Kerkese drejtuar Bashkise per te raportuar ne lidhje me keto sherbime,raportim ne Keshill.
	Pjesmarrje ne aktivite te rendesishme vjetore,konferenca dhe aktivite me interes per K.B
Maj	Mbledhje e Keshillit Bashkiak
	Mbledhje e komisioneve te perhershme te K.B
	Paraqitja e raportit per aktivitetin financiar dhe zbatimin e buxhetit vjetor te vitit paraardhes I cili duhet te jete I krahasueshem me planin e buxhetit vjetor.
	Analize,monitorim I punes se ndermarrjes Ujesjelles Kanalizime sh.a
	Pjesemarrje ne trajnime per sekretariatin e K.B
	Pjesemarrje ne trajnime per keshilltaret.
	Pjesmarrje ne aktivite te rendesishme vjetore,konferenca dhe aktivite me interes per K.B
Qershor	Mbledhje e Keshillit Bashkiak
	Mbledhje e komisioneve te perhershme te K.B
	Miratim I fazes 1 te PBA,duke shprehur edhe opinionin e tij per rekomandimet e Ministrise se Financave.
	Rishikim buxheti
	Informim I komunitetit dhe transparenca e veprimtarise se Keshillit,llogaridhenia e keshillit,Promovim I procedurave te ankesave,kerkesave peticioneve dhe nismave qytetare.
	Ceremoni per dhenie tituj nderi
	Hartim I Planit te Monitorimit te: Sherbimit te pastrimit,Sherbimeve sociale,Arsimit baze dhe parashkollor,Investimeve publike etj.Kerkese drejtuar Bashkise per te raportuar ne lidhje me keto sherbime,raportim ne Keshill.
	Pjesmarrje ne aktivite te rendesishme vjetore,konferenca dhe aktivite me interes per K.B
	Hartimi I raportit te degjesave
Korrik	

	Mbledhje e komisioneve te perhershme te K.B
	Miratimi itavaneve perfundimtare te PBA
	Ndryshim buxheti
	Pjesmarrje ne aktivite te rendesishme vjetore, konferenca dhe aktivite me interes per K.B
Gusht	Mbledhje e Keshillit Bashkiak
	Mbledhje e komisioneve te perhershme te K.B
	Ndryshim buxheti
	Pjesmarrje ne aktivite te rendesishme vjetore, konferenca dhe aktivite me interes per K.B
Shtator	Mbledhje e Keshillit Bashkiak
	Mbledhje e komisioneve te perhershme te K.B
	Hartim I Planit te Monitorimit te: Sherbimit te pastrimit, Sherbimeve sociale, Arsimit baze dhe parashkollor, Investimeve publike etj. Kerkese drejtuar Bashkise per te raportuar ne lidhje me keto sherbime, raportim ne Keshill.
	Pjesemarrje ne trajnime per keshilltaret.
	Konsultime me komunitetin per sherbimet e pastrimit, te sherbimeve sociale, te arsimit baze dhe parashkollor.
	Hartimi I raportit te degjesave
	Ndryshim buxheti
	Vizite studimore jashte vendit
	Takom me shoqerine civile, promovim I iniciativave dhe peticioneve qytetare.
	Pjesmarrje ne aktivite te rendesishme vjetore, konferenca dhe aktivite me interes per K.B
Tetor	Mbledhje e Keshillit Bashkiak
	Mbledhje e komisioneve te perhershme te K.B
	Ndryshim buxheti
	Monitorim I realizimit te 8-mujorit.
	Konsultime me komunitetin per sherbimet e pastrimit, te sherbimeve sociale, te arsimit baze dhe parashkollor.
	Hartimi I raportit te degjesave
	Pjesmarrje ne aktivite te rendesishme vjetore, konferenca dhe aktivite me interes per K.B
Nentor	Mbledhje e Keshillit Bashkiak
	Mbledhje e komisioneve te perhershme te K.B
	Konsultime me komunitetin per sherbimet e pastrimit, te sherbimeve sociale, te arsimit baze dhe parashkollor.
	Hartimi I raportit te degjesave
	Kerkese drejtuar bashkise ne mbledhjen e keshillit per te reflektuar mendimet e qytetareve ne buxhet.
	Pjesmarrje ne aktivite te rendesishme vjetore, konferenca dhe aktivite

	me interes per K.B
Dhjetor	Mbledhje e Keshillit Bashkiak
	Mbledhje e komisioneve te perhershme te K.B
	Miratimi I buxhetit dhe PBA
	Miratim I paketes Fiskale
	Miratim I prioriteteve te investimeve ne Bashki
	Emission ne media locale dhe online per buxhetin
	Pjesmarrje ne aktivite te rendesishme vjetore, konferenca dhe aktivite me interes per K.B

	dhe administrim	<ul style="list-style-type: none"> Shërbime të përgjithshme publike, si: shërbimet e prokurimit, mbajtja dhe ruajtja e dokumenteve dhe arkivave të njësisë, ndërtesave në pronësi apo të zëna nga njësia, parce qendrore automjetesh, zyrave të printimit dhe IT etj. Administrim, funksionim dhe ofrimi i shërbimeve të mbështetjes për kryetarin e njësisë vetëqeverisjes vendore, për këshillin dhe komisionet e këshillit ose të kryetarit të njësisë. Shërbimet statistikore dhe baza e të dhënave vendore; Prodhim dhe përhapje e informacionit publik, dokumentacionit teknik dhe statistikave për çështjet dhe shërbimet për zhvillimin e komunitetit;
01170	Gjendja Civile	<ul style="list-style-type: none"> Fondet e pushtetit qendror për funksionin e deleguar të gjendjes civile në njësitë e vetëqeverisjes vendore;

Tavanet per PBA 2021-2023 jane si me poshte :

Në mijë lekë

Nr	Emertimi i Programit	2021				2022				2023			
